



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

për vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë

Drejtuar: Z. Hekuran Murati, ministër
Ministria Financave, Punës dhe Transfereve

Kopje: Z. Enis Spahiu, sekretar
Ministria Financave, Punës dhe Transfereve

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 18 nëntor 2022

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (në tekstin e mëtejshëm: MKP) i Avokatit të Popullit, më 19 maj 2022 ka vizituar Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (në tekstin e mëtejshëm: ShPMPF).

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitës

1. Gjatë vizitës së MKP-së në ShPMPF, personeli i institucionit i ofroi ekipit monitorues bashkëpunim të plotë, qasje në dokumentacionin relevant, si dhe ia mundësoi bisedat me rezidentët, pa praninë e zyrtarëve të institucionit.

Informata të përgjithshme

2. ShPMPF-ja është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejshëm: MFPT). Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 100 persona. Gjatë vizitës, në ShPMPF ishin të akomoduar 63 rezidentë, prej tyre 28 meshkuj dhe 35 femra. Nga ata, 3 persona janë nën moshën 65 vjeç.
3. Me Rregulloren nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja) rregullohet çështja e kriterëve për pranimin e rezidentëve, organizimi i jetës dhe i punës me shfrytëzuesit (rezidentët), rregullat shtëpiake dhe aktivitetet, mbrojtja shëndetësore e shfrytëzuesve, si dhe çështje të tjera rreth jetës dhe punës së shfrytëzuesve të ShPMPF-së.¹
4. Neni 1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2014 për Punën dhe Kriteret e Vendosjes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare tregon më hollësisht kriteret për vendosjen e rezidentëve në këtë institucion.
5. Legjislacioni i Republikës së Kosovës nuk përcakton vendosje të pavullnetshme në institucionet e kujdesit social. Të gjithë rezidentët e vendosur në këtë institucion janë të vendosur bazuar në kontratën e nënshkruar me institucionin në fjalë. Prandaj konsiderohet se të gjithë rezidentët janë vendosur këtu mbi bazën e vullnetit të tyre.

Kategoritë e rezidentëve

6. Në ShPMPF vendosen rezidentët si në vijim: Shfrytëzuesit e varur (të palëvizshëm), të cilët nuk mund t'i realizojnë nevojat e tyre jetësore në mënyrë të pavarur, por duhet të ndihmohen gjithmonë nga të tjerët. Kategoria e rezidentëve gjysmë të varur, gjendja shëndetësore e të cilëve ka shënuar rënie dhe pranojnë kujdes të veçantë. Kategoria tjetër janë shfrytëzuesit e pavarur, të cilët, edhe pse janë të moshuar, plotësojnë nevojat e tyre jetësore pa ndihmën e të tjerëve.

Kriteret për vendosjen e rezidentëve në ShPMPF

7. Neni 5 i Udhëzimit Administrativ 10/2014 përcakton kriteret themelore për vendosjen e rezidentit në ShPMPF. Sipas këtij neni, duhet të plotësohen kriteret në vijim: personi të jetë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës, të jetë mbi moshën 65 vjeç, të mos ketë

¹ Neni 1 i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

pasardhës-fëmijë biologjikë apo të birësuar, të jetë në gjendje të mirë psikike dhe të mos ketë sëmundje infektive.

8. Megjithatë, gjatë vizitës dhe kontrollimit të dokumenteve relevante, MKP-ja ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe persona me diagnoza të ndryshme psikiatrike, personat me aftësi të kufizuara mendore apo ngecje në zhvillim mendor. Sipas njoftimit të zëvendësueses së punëtorit social, 17 rezidentëve u është marrë zotësia e veprimtimit.
9. Po ashtu, MKP-ja ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe 3 persona, të cilët janë nën moshën 65 vjeç. Akomodimi i tyre në këtë institucion është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 10/2014 dhe me Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

Daljet e rezidentëve nga ShPMPF-ja

10. Për daljet në qytet, rezidentët janë të obliguar ta njoftojnë zyrtarin për punë sociale, ndërsa për vizita familjare duhet të marrin leje me shkrim. Largimi pa leje nga institucioni llogaritet si ikje nga institucioni.² Nëpunësi i ShPMPF-së, kur vëren se gjatë ndërrimit të vet i mungon ndonjë rezident në repart, është i obliguar të kontrollojë brenda institucionit në të gjitha repartet e tjera dhe, nëse vërteton se nuk gjendet, atëherë lajmëron organet e rendit dhe nëpunësin e shërbimeve sociale.³

Keqtrajtimi fizik

11. Gjatë vizitës, MKP-ja ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo abuzime verbale, si dhe për sjellje të cilat do ta shkelnin dinjitetin njerëzor të rezidentëve në ShPMPF. MKP-ja çmon lart angazhimin e personelit për kujdesin ndaj të moshuarve, sidomos ndaj të moshuarve të palëvizshëm. MKP-ja fitoi përshtypjen se marrëdhëniet e personelit me rezidentët janë të mira dhe miqësore.
12. MKP-ja ka vërejtur se hapësirat e jashtme të institucionit janë të mbuluara me kamera të sigurisë, të cilat mbulojnë hapësirat e jashtme të ShPMPF-së.

Dhuna ndërmjet rezidentëve

13. Drejtoria pretendon se gjatë këtij viti nuk janë shënuar raste të dhunës ndërmjet rezidentëve, përpos ndonjë fjalosjeje. Ky pohim u verifikua edhe përmes kontrollit të dokumentacionit relevant, si dhe përmes intervistimit të banorëve në ShPMPF.

Kushtet e akomodimit

14. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se oborri dhe trotualet e institucionit ishin rregulluar dhe qasja për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara ishte dukshëm më e lehtë. Mirëpo, sipas drejtorisë, ka pasur rinovime në ambientin e jashtëm, por nuk janë përfunduar për shkak të shkëputjes së kontratës nga nënkontraktori. MKP-ja ka vërejtur se ekziston një ashensor që është funksional, por është shumë i vjetër dhe shpesh pëson defekte, si dhe hapësira është e pamjaftueshme për rezidentët që lëvizin me karroca. Hapësira e vogël e ashensorit ua pamundëson rezidentëve daljen në oborr. Kjo është një

² Neni 51 i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

³ Neni 52 i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

arsye e dukshme, e cila ka detyruar institucionet relevante të marrin iniciativë që të ndërtohet një ashensor me përmasa standarde për rezidentët të cilët janë me aftësi të kufizuara, e po ashtu për rastet emergjente, të cilat duhet të barten me krevate (shtretër) për trajtim jashtë institucionit ose në rast vdekjeje. MKP-ja ka vërejtur se ndërtimi i një ashensori të ri kishte filluar, por punimet ishin ndërprerë për shkak se nënkontraktori e kishte ndërprerë kontratën.

15. MKP-ja gjatë vizitës në ShPMPF ka marrë ankesë nga rezidenti G. S., i cili është me aftësi të kufizuara në karrocë dhe i cili pohoi se që tri vjet nuk ka pasur qasje në oborr, për shkak të hapësirës së vogël të ashensorit. Lidhur me këtë ankesë, MKP-ja sërish ka kërkuar nga organet kompetente që gjendja e krijuar të përmirësohet sa me shpejt, duke i bërë aranzhimet e nevojshme në mënyrë që rezidenti ta gëzojë të drejtën e vet, në mënyrë të barabartë me banorët e tjerë dhe pa asnjë diskriminim.

Gjithashtu, nga udhëheqësi i divizionit jemi informuar se janë kryer procedurat e tenderimit për instalimin e një ashensori sipas standardeve, por që operatori ekonomik për shkak të ngritjes së çmimeve i ka ndërprerë punimet.

16. MKP-ja ka vërejtur se nuk ka probleme sa i përket furnizimit me ujë, janë sjellë bojlerët e rinj nga ministria, po ashtu edhe lavatriçet e reja janë sjellë nga ministria.
17. Dhomat ku vendosen rezidentët kanë ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kanë lagështi, por inventari është i vjetërsuar dhe i dëmtuar në disa dhoma. Po ashtu, edhe banjat janë shumë të dëmtuara. Me veshmbathje dhe dyshekë të rinj janë furnizuar nga ministria. Rezidentët janë të vendosur në dhoma nga 3, 2 dhe 1 person. Sipas drejtorisë, nuk ka pasur problem me ngrohje gjatë dimrit, sepse kanë pasur lëndë djegëse të mjaftueshme.

Ushqimi

18. Sipas nenit 4.4 të Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare, ushqimi përgatitet në kuzhinën e përbashkët me një meny të unifikuar, si dhe merret mendimi i shfrytëzuesve për përcaktimin e menysë.
19. Më tej, sipas nenit 4.5 të Rregullores, shfrytëzuesit kanë të drejtë për zgjedhjen e menysë sipas rregullave fetare. Po ashtu, shfrytëzuesit kanë të drejtë të kenë ushqimin sipas udhëzimit të mjekut përgatitet menyja dietale.
20. MKP-ja ka vërejtur se kuzhina posedon meny ushqyese dhe meny dietale. MKP-ja ka vërejtur se kuzhina është në gjendje të mirë dhe mbahet e pastër, ndërsa makineritë për përgatitjen e ushqimit janë funksionale.

Aktivitetet psiko-sociale

21. Sipas nenit 9 të Rregullores, në ShPMPF organizohet programi i punës me shfrytëzuesit e varur, gjysmë të varur dhe të pavarur. Shfrytëzuesit e aftë për punë angazhohen në punë aq sa është e paraparë me programe profesionale nga terapia e punës.⁴
22. Neni 12 i Rregullores përcakton se rezidentët kohën e lirë e kalojnë duke pushuar, duke u marrë me aktivitete argëtuese dhe kulturore, në përputhshmëri me programet e këtyre

⁴ Neni 11 i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

aktiviteteve. Në kuadër të institucionit funksionon klubi i të moshuarve, organizohen 3 shëtitje gjatë vitit, terapi për rezidentët. Programi i punës hartohet nga shërbimi social dhe terapia e punës në pajtueshmëri me shërbimin shëndetësor, duke ia përshtatur aftësi të çdo shfrytëzuesi që angazhohet në punë.⁵

23. Çdo kat i institucionit posedon sallat e pajisura me TV, ku të moshuarit aty e kalojnë kohën e lirë. Gjithashtu institucioni posedon edhe sallën e aktiviteteve ku zakonisht të moshuarat punojnë punë dore. Në klubin e rezidentëve është një hapësirë e përbashkët ku qëndron psikologu dhe terapeuti i punës. Klubi i rezidentëve posedon edhe një hapësirë për lojëra me shah, domino dhe letra, ku rezidentët kanë mundësi të luajnë dhe ta kalojnë kohën e lirë.
24. Sipas drejtorisë, prej paraqitjes së pandemisë COVID-19, nuk kanë realizuar aktivitete jashtë institucionit.

Kujdesi shëndetësor

25. Personeli shëndetësor në ShPMPF përbëhet nga: 1 mjek i rregullt, i cili është në specializim dhe punon nga ora 14:00; një stomatolog me orar të plotë; një kryeinfermier dhe 9 infermierë, të cilët punojnë me ndërrime (12/12); dhe një ndihmës asistente për shërbime stomatologjike me orar të plotë; një farmacist me orar të plotë (8-16), 2 fizioterapeutë me orar të plotë, 1 teknik sanitar, 1 punëtore në lavanderi, 2 mirëmbajtës të higjienës. Në përbërje të personelit mjekësor janë edhe 14 ndihmës mjekësor, të cilët kujdesen për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe për personat e palëvizshëm. Përkujdesja ndaj këtyre personave bëhet me mbikëqyrje të vazhdueshme, ku personeli kujdeset për higjienën e tyre personale, për ushqimin e rregullt, si dhe për nevojat e tjera të rastit.
26. Në përbërje të personelit mjekësor është edhe një psikologe, e cila punon me orar të plotë, dhe një psikolog praktikant për kohë të caktuar, ndërsa psikiatri punon dy herë në javë me kontratë. Kujdesi shëndetësor bëhet sipas nevojave individuale dhe të atyre të përgjithshme. Vizitat sistematike bëhen së paku një herë në 6 muaj. Shërbimi mjekësor posedon protokolle të veçanta për vetëlëndime, për lëndime trupore, për grevë urie, për abuzime seksuale, për vetëvrasje, si dhe për vdekjeve në institucion. MKP-ja ka vërejtur se janë të furnizuar mjaftueshëm me barna dhe se terapia shpërndahet me rregull nga infermierët.
27. MKP-ja u njoftua se gjatë këtij viti në këtë institucion nuk ka ndërruar jetë asnjë rezident, kurse gjatë vitit paraprak 2021 kanë ndërruar jetë 2 rezidentë.
- Nga numri i përgjithshëm i rezidentëve (63) janë identifikuar 42 rezidentë me terapi psikiatrike, 21 rezidentë që kanë nevojë për asistencë të vazhdueshme edhe për nevoja personale, nga ky numër 13 janë plotësisht të varur dhe 12 pjesërisht të varur. Të gjithë rezidentët janë të vaksinuar me dy vaksina.
28. Në total, personeli i ShPMPF-së ka në përbërje 50 zyrtarë, kurse me strukturën organizative (organogram) janë të paraparë 60 të tillë, përfshirë këtu edhe shërbimin mjekësor. Ndërsa, përveç personelit mjekësor, ShPMPF-ja në përbërje të vet ka shërbimin administrativ, social, shërbimin e kuzhinës dhe shërbimin teknik. Në kuadër të shërbimit

⁵ Neni 11, paragrafi 2, i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

administrativ janë të angazhuar 3 zyrtarë, ndërsa në kuadër të shërbimit social 1 zyrtare (zëvendësim nga terapia e punës). Gjatë vizitës në ShPMPF, ekipi i MKP-së u njoftua se janë duke u zhvilluar procedurat e konkursit për pozitat: Shef i shërbimit social (1 pozitë); ndihmës mjekësor (2 pozita); udhëheqës i kuzhinës (1 pozitë); servuese (2 pozita).

Trajnimet për stafin e ShPMPF-së

29. Sipas pohimeve të drejtoreshës, stafi i shërbimit mjekësor ka pasur trajnime, kurse punëtorët socialë dhe stafi tjetër administrativ nuk kanë mbajtur trajnime. MKP-ja inkurajon autoritetet t'i vlerësojnë nevojat e stafit dhe të zhvillojnë programe të trajnimeve për tërë stafin.

Kontakti me botën e jashtme

30. Neni 16, paragrafi 1, i Rregullores nr.09/2008 mbi organizimin e brendshëm të punës për ShPMPF-në përcakton se shfrytëzuesit mund të mungojnë në ShPMPF me kërkesë të të afërmeve, mirëpo me leje të lëshuar nga nëpunësi i shërbimeve sociale në konsultim me mjekun, nëse rezidenti ka probleme shëndetësore, në periudhën kohore deri në 30 ditë të kohëpaskohshme. Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se rezidentët që janë të dhënë pas alkoolit, bixhozit dhe problemeve të tjera, mund të dalin në qytet me leje me shkrim nga nëpunësi i shërbimeve sociale dhe vetëm me përcjellës, i cili i korrigjon sjelljet e tij.

31. Kurse në rast të nevojave të kontrolleve specialistike apo për të kryer ndonjë punë në organet shtetërore, shfrytëzuesi mund të dalë vetëm nën përcjelljen e infermierit, gjegjësisht të nëpunësit të shërbimeve sociale.⁶

32. Ndërsa bazuar në nenin 42, rezidentët njoftohen për kohën e përcaktuar të vizitave nga jashtë, të cilat caktohen nga shërbimi social në marrëveshje me shërbimin shëndetësor dhe orari vendoset në tabelën e shpalljeve të ShPMPF-së. Vizitat e shfrytëzuesve mund t'i ndërpresë vetëm drejtori i ShPMPF-së dhe atë në kohë të caktuar në rast të ndonjë epidemie apo të ndonjë rrezikshmërie tjetër për shfrytëzuesit.

33. Lidhur me këtë të drejtë, MKP-ja e IAP-së, është njoftuar nga mediat se një rezident ka pranuar nga jashtë një vizitore gjatë ditës së diel, e cila ka refuzuar të identifikohet tek punëtorët e sigurimit, por edhe tek punëtorët e shërbimit shëndetësor. Pas kësaj, ka pasuar ankesa e punëtorëve shëndetësor tek udhëheqësit e qendrës, të cilët menjëherë kanë ndërmarrë masa duke nxjerr një Vendim, të cilin e kanë vendosur në hyrje të qendrës dhe me të cilin kanë njoftuar se: “Njoftim që vizitat për rezidentët e ShPMPF-së, të bëhen nga ora 08.00h deri në orën 16.00h gjatë ditëve të punës, në mënyrë që të jenë në përcjellje të shërbimit social dhe të evidentohet çdo vizitorë edhe tek sigurimi, për arsye se po ka raste të vizitorëve të cilët nuk lajmërohen tek punëtorët e sigurimit duke penguar punëtorët e ndërrimit të pasdites”.

34. Pas këtij njoftimi, Avokati i Popullit ka realizuar vizitë në ShPMPF, dhe është informuar se ky vendim është nxjerr bazuar në nenin 43 të Rregullores 09/2008, i cili përcakton se: “Vizitori nuk mund të hyjë në objekt, përderisa nuk lajmërohet tek punëtori i sigurimi të ShPMPF-së”, ndërsa paragrafi 2, po ashtu përcakton se “Vizitori është i obliguar që të ofrojë dokumentin e identifikimit tek personi zyrtar dhe të lejojë kontrollimin e gjësëndeve që i dërgon shfrytëzuesit”. Andaj edhe vendimi që është nxjerr bazuar në

⁶ Po aty, neni 16.3.

rregullore, ka pas për qëllim ruajtjen e dinjitetit të rezidentëve, mirëqenien dhe sigurinë e tyre, duke pas parasysh ndjeshmërinë e institucionit dhe kategorinë shumë të ndjeshme të rezidentëve në atë institucion.

35. Avokati i Popullit është njoftuar nga menaxhmenti i ShPMPF-së, se ata janë të hapur për vizita, por vetëm duhet të respektohet rendi shtëpiak, hierarkia institucionale dhe më e rëndësishmja ruajtja e dinjitetit të secilit rezident.

Masat disiplinore

36. Sipas nenit 21 të Rregullores, për shfrytëzuesit të cilët në mënyrë të përhershme e prishin rendin shtëpiak në institucion dhe pas vërejtjeve nuk shihen gjasat e përmirësimit të sjelljeve të tyre, diskutohet në kolegjiun e ShPMPF-së, pastaj vendoset për hapat e mëtuajtshëm deri tek vlerësimi i komisionit disiplinor. Sipas drejtorisë, masa e vetme e cila ndërmerret ndaj tyre është vërejtja gojore. Ky pohim u verifikua edhe përmes kontrollit të dokumentacionit relevant dhe intervistimit të rezidentëve.
37. Më tej neni 55 i Rregullores parasheh themelimin e komisionit disiplinor të shkallës së parë prej tre anëtarësh, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e rasteve që kanë të bëjnë me prishjen e rendit shtëpiak. Komisioni zgjidhet nga drejtori i institucionit. Ky komision është përgjegjës për shqyrtimin e rasteve të shfrytëzuesve që kanë të bëjnë me keqpërdorime apo me sjellje abuzive në raport me stafin apo me rezidentët.
38. Neni 56 i Rregullores parasheh që nëse masat e shqiptuara nga komisioni i shkallës së parë nuk janë respektuar apo shfrytëzuesi nuk është i kënaqur me masën e shqiptuar, përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të shfrytëzuesve është komisioni i shkallës së dytë. Ky komision përbëhet prej tre anëtarësh, një nga Qendra për Punës Sociale, përkatësisht kujdestari i shfrytëzuesit, një nga Sektori i Personave të Moshuar në kuadër të Departamentit për Përkujdesje Institucionale (DPI) dhe anëtari i tretë zgjidhet nga drejtori i institucionit.

Procedura e parashtrimit të ankesave

39. Rezidentët të cilëve gjendja shëndetësore ua mundëson këtë, mund të parashtrorjnë ankesa dhe parashtrësia në departamentin përkatës të MFPT-së dhe të drejtorisë së institucionit. Rezidentët po ashtu mund t'i parashtrorjnë ankesat e tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër institucionit ku janë të akomoduar dhe kundër institucioneve publike të Republikës së Kosovës. Ankesat në IAP rezidentët mund të bëjnë përmes telefonit, postës, postës elektronike dhe duke u paraqitur personalisht në institucion. Po ashtu, institucioni kohë pas kohe vizitohet nga OJQ të ndryshme, të cilat, përveç aktiviteteve që zhvillojnë me rezidentët, pranojnë edhe ankesat e rezidentëve.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON


Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që :

- **Sa më parë që është e mundur të funksionalizohet ashensori.**
- **Rezidentët të furnizohen me inventar adekuat në dhomat e tyre.**

- Të bëhet rinovimi i banjave.
- Të organizohen trajnime specifike për personelin në pajtim me nevojat për trajtim të rezidentëve.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit